

PKR.nr.21/18

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË, DEPARTAMENTI I KRIMEVE TË RËNDA – Kryetarja e trupit gjykues Shadije Gërguri me bashkëpunëtorin profesional Driton Berisha, në çështjen penale ndaj të akuzuarit L.B për shkak të veprës penale Lëndim i rëndë trupor nga neni 189 par.5 lidhur me par.1 të KPRK-së dhe veprës penale Mbajtja në pronësi, kontrollë ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KPRK-së, i akuzuari E.T për shkak të veprës penale: Përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 375 par.2 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë PP/L.nr.258/2017, të datës 30.01.2018, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar, verbal e publik me dt: **05.03.2018** në prezenc të prokurorit të shtetit Hivzi Bajraktari, të akuzuarit L.B me mbrojtësin av. A.J sipas autorizimit dhe E.T me mbrotësin av.I.H sipas detyrës zyrtare, të njëjtën ditë mori dhe publikisht shpalli:

A K T G J Y K I M

TË AKUZUARIT:

L.B, nga i ati B., e ëma S, e gjinisë M., i lindur me dt:..., në P., ku dhe jeton në rr. “V”, objekti T. kati ., ka të kryer shkollën e mesme, i pa martuar, i punësuar në biznes familjarë, thertore “K”, në Prishtinë, i gjendjes së mesme ekonomike, Shqiptar, Shtetas i R.Kosovës, me nr. personal:...

E.T nga i ati N, e ëma E, e gjinisë M, i lindur me dt... në P, ku dhe jeton në rr. “A Zh”, numër ., ka të kryer shkollën fillore, i pa martuar, i pa punë, i gjendjes së dobët ekonomike, Shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës. Me nr. personal:...

JANË FAJTOR

SEPSE: Më date 06.12.2017 rreth orës 17:50 në Prishtinë në lagjen Dardania rruga “Idriz Gjilani” mbi kurriz në lokal-in-kafiterin ‘V’ me dashje i ka shkaktuar lëndime trupore të dëmtuarit G.K, në atë mënyr që pasi të pandehurit L.B dhe E.T kan shkuar në lokal-in e latëcekur janë ulur në një tavolin, e kan vërejtur dëshmitaren E.D të ulur në tavolin me të dëmtuarin G.K dhe E.A, i pa ndehuri L.B e fton ish te dashuren e tij E.D të ulet në tavolinen e të pandehurve, e njejta shkon dhe ulet me ta dhe gjatë bisedes i pandehuri L. i thot pse po rrin me ata persona, shko merri gjësendet tua dhe eja të shkojm dikund tjet, e njejta nuk ka pranuar dhe ipandehuri L. i ka then të pandehurit E. për ti marr gjësendet e saj dhe i pandehuri E. shkon te tavolina e të demtuarve për ta marr pallton dhe qanten e

dëshmitares e pas tij shkon edhe dëshmitarja E. dhe aty i pandehuri E. fillon të fjaloset me të demtuarit, në atë moment aty shkon edhe ipandehuri L. i cili se bashku me të pandehurin E. fillojnë të kacafyten me të demtuarit, ku në atë qast i pandehuri E. e nxjerr nga xhepi thiken flutur me të cilin iu është kanosur për ti goditur të demtuarit, ndërsa i pandehuri L. e nxjerr revolen e tipit “zoraki N906-B” me numër serik 0004240917 të kalibrit 7.65 mm dhe me të ka shten një herë në drejtim të demtuarit G.K të cilin e qëllon në këmbën e majt në pjesën nën gju pastaj të pandehurit ikin nga vendi i ngjarjes në drejtim të panjohur me që rast të demtuarit i shkaktojnë plag tejkuese në regjionin e kërcirrit-nën gjurit të këmbës së majt më thyrje të kockës së kërcirrit-tibisit të shkaktuar nga veprimi dinamik i predhës së hedhur nga arma e zjarrit dhe si të tilla bëjnë pjesë në dëmtime të rënda trupore,-

- Me këtë ka kryer veprën penale lëndim i rënd trupor nga neni 189 par.5 lidhur me par 1. të KPRK-së

Nga data e pacaktuar deri me 28.10.2016 ka mbajtur në pronësi në shkëlqje më ligjin e zbatueshëm lidhur me arm të tilla, revolen e tipit “zoraki M906-B” me numër serik 0004240917, të kalibrit 7.65mm të cilën e ka përdorur me rastin e kryerjes së veprës penale të përshkruar si në dispozitivin e parë dhe e njejtë arm me një karikator dhe 4 fishek me datën 28.10.2016 me rastin e ndalimit nga policia është sekuestruar,-

- Me këtë ka kryer veprën penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të pa autorizuar të armëve nga neni 374 par 1 të KPRK-së.

I pandehuri E. T

më datë, kohë, vend dhe mënyrën e veprimeve të përshkruara sinë dispozitivin e parë në mënyrë kërcënuese dhe frikësuese kundër të demtuarve të lartëcekur ka përdorur armen e ftoht thiken flutur në atë mënyrë siq është përshkruar si në dispozitivin e parë, i demtuar G. i ka thënë të demtuarit E. për ti marrë gjësendet e dëshmitares E. dhe i pandehuri E. shkon te tavolina e të demtuarve për të marrë qanten dhe pallton e dëshmitares, pas tij shkon edhe dëshmitarja E. dhe posa është shkuar te tavolina e të demtuarve i pandehuri E. fillon të fjaloset me të demtuarit dhe në atë moment aty shkon edhe i pandehuri L. i cili se bashku me të pandehurin E. fillojnë të kacafyten me të demtuarit ku në atë qaste i pandehuri E. e nxjerr nga xhepi thiken flutur me të cilin të demtuarve në mënyrë kërcënuese iu është kanosur për ti goditur,-

- me këtë ka kryer veprën penale përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 375 par 2 të KPRK-së

Andaj gjykata me aplikimin e **neneve 2,3,7,17,41,42,43,45,49,50,51,53, 62,73,74,75 të KPRK-së** dhe nenit 365 dhe 450 dhe 463 të KPRK-së, i:

G J Y K O N

Të akuzuarin L.B për veprën penale lëndim i rënd trupor nga neni 189 par.5 lidhur me par 1 të KPRK-së I shqipton DËNIM ME BURGIM në kohëzgjatje prej 1 vit e 6 muaj e në të cilin denim do ti llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim nga data 14.12.2017 deri me

date 05.03.2018 dhe për veprën penale mbajtja në pronsi, kontroll ose posedim të pa autorizuar të armëve nga neni 374 par 1 të KPRK-së shqipton DËNIM ME GJOBË në shumë prej 1000 euro, të cilën është i obliguar ta paguaj 15 dite nga plotfuqishmëria e këtij aktgjykimi. Nëse i akuzuari nuk dëshiron ose nuk mund ta paguajë gjobën e shqiptuar e njëjta do të shndërrohet në dënim me burgim duke ia llogaritur për çdo ditë burgim 20 euro gjobë.

Gjykata komform nenit 80 par.1 dhe 2 pika 2.5 të KPRK-së të akuzuarit L.B i shqipton dënim unik me burg në kohëzgjatje prej 1 viti e 6 muaj dhe dënim me gjobë në shumën prej 1.000 € eurove të cilin dënim i njëjti është i obliguar ta paguj në afatin prej 15 ditëve nga plotfuqishmëria e këtij aktgjykimi.

Te akuzuarin E.T i shqiptohet DËNIM ME BURGIM në kohëzgjatje prej 10 muajve i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse brenda periudhes prej një viti nuk kryen vepër tjetër penale, dhe DËNIM ME GJOBË në shumë prej 300 € euro i cili dënim duhet të paguhet në afat prej 15 dite nga plotfuqishmëria e këtij aktgjykimi. Nëse i akuzuari nuk dëshiron ose nuk mund ta paguajë gjobën e shqiptuar e njëjta do të shndërrohet në dënim me burgim duke ia llogaritur për çdo ditë burgim 20 euro gjobë.

Të dëmturit G.K nga P, rruga “A.K ” pn, dhe E.A nga P. për realizimin e kërkesës pasuroro juridike udhëzohen në kontest civil

Detyrohen të akuzuarit që t'i paguajnë shpenzimet e procedurës penale, aq sa do të jenë sipas llogarisë përfundimtare të kësaj Gjykate, ndërsa shpenzimet në emër të paushallit gjyqësorë, shumën nga 50 euro (pesëdhjet) €, secili veq e veq brenda afatit prej 15 ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prishtinë-Departamenti për krime të rënda ka ngritur aktakuzë PP/I.nr.258/2017, të datës 30.01.2018, kundër të akuzuarit L.B për shkak të veprës penale Lëndim i rëndë trupor nga neni 189 par.5 lidhur me par.1 të KPRK-së dhe veprës penale Mbajtja në pronësi, kontrollë ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KPRK-së, ndërsa që të akuzuarin E.T për shkak të veprës penale Përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 375 par.2 të KPRK-së.

Gjykata ka caktuar seancën e shqyrtimit fillestar me datën 05.03.2018 dhe pasi që të akuzuarit janë njoftuar me të drejtat e tyre në kuptim të nenit 246 të KPPK-së, kanë deklaruar se e kanë kuptuar aktakuzën, nuk kanë nevojë për sçarim shtesë, dhe pasi që ju është dhënë mundësia që të pranojnë fajësinë lidhur me veprat penale që i janë vënë në barrë, të akuzuarit, në kuptim të nenit 248 të KPPK-së, kanë deklaruar se e pranojnë fajësinë për veprat penale me të cilat ngarkohen me aktakuz nga ana e prokurorisë, pranimin e fajësisë e kanë bërë me dëshirë dhe të vetëdijshëm për pranimin e fajësisë, pasojat dhe benifitet e pranimit të fajit.

Prokurori i shtetit nuk ka pasur vërejtje me pranimin e fajsis nga të akuzuarit L.B dhe E. T.

Gjykata pas pranimit të fajsis të të akuzuarve, ka marr aktvendim që ta aprovoje pranimin e fajësisë pasi që u bind se të akuzuarit e kanë kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajit, pranimi është bërë vullnetarisht, pranimi i fajit mbështetet në faktet e

çështjes që përmbanë aktakuza, në materialet e prezentuara nga prokurori i shtetit dhe aktakuza nuk përmbanë asnjë shkelje të qartë ligjore, ose gabime faktike.

Duke marr parasyshë se pranimi i fajësisë është arritur në shqyrtimin fillestar konform nenit 248 par.4 të KPPRK-së kur kryetari i trupit gjykues mundë të vazhdon procedurën me shqiptimin e denimit pa shkuar fare në shqyrtim gjyqësorë dhe pa e plotësuar trupin gjykues, gjykata pa fjalë përfundimtare, pas pranimit të fajësisë nga ana e të akuzuarës dhe pasi që bindet se janë vërtetuar faktet lidhur me pranimin e fajësisë, të njejtën ditë vazhdoi me shqiptimin e denimit, duke marr parasyshë se e akuzuara veprën penale e ka kryer me dashje direkte, ka qenë e vetëdijshëme për veprën e saj dhe e ka dashur kryerjen e saj.

Me rastin e përcaktimit të llojit të lartësis së dënimit Gjykata pati parasyshë të gjitha rrethanat letësuese dhe rëndësuese që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e denimit, kështu që ndaj të akuzuarve si rrethana veqanarisht lehtësuese të cilat i kanë mundësuar Gjykatës zbatimin e dispozitave ligjore lidhur me zbutjen e dënimit, ka marrur pranimin e fajësisë dhe pendimin e thellë nga të akuzuarit pendim ky që është shprehur që në deklaratat që kan dhen në procedurat paraprake, dhe moshen e re të tyre ne kohen e kryerjeve te veprave penale, po ahstu si rrethana lehtësuese gjykata për të njëjti ka gjetur sjelljen korrekte në gjykatë, kërkim faljen dhe premtimin se nuk do të kryejn më vepra penale e po ashtu për të akuzuarin E.T gjendjen e dobët ekonomike të të njejtit. Andaj gjykata të njejtit i shpalli fajtor dhe i gjykoi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, me bindje se denimi i shqiptuar i përgjigjet shkallës dhe përgjegjësisë penale dhe më të njejtët do të arrihet qëllimi i dënimit.

Gjykata është e bindur se me dënimin e shqiptuar në tërësi do të arrihet qëllimi i denimit siç është rregulluar me nenit 41 të KPRK-së.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale dhe paushallit gjyqësorë, është marr konform dispozitave të nenit 450 par.2 pika 2.6 të KPPRK-së.

Vendimi për udhëzimin e të dëmtuarve në kontest civil për realizimin e kërkesës pasuroro –juridike është marr konform dispozitës ligjore 463 parg 1 të KPPK-së .

Nga sa u cek me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
DEPARTAMENTI PËR KRIME TË RËNDA
PKR.nr. 21/18 , të dt: 05.03.2018**

**Kryetarja e trupit - gjyqtarja,
Shadije Gërguri**

**Bashkëpuntori profesional
Driton Berisha**

KESHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 /pesëmbëdhjetë/ ditë nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e përmes kësaj Gjykate